



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI

Nr. 3468 prot.  
/4

Pogradec, më 13.08 2024

**Lënda:** Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

**Znj. Manjola Kamolli, KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**E nderuar zonja Kryetare,**

Bashkëngjitur po ju dërgojme projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues , për:

**" DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 133, DATË 11.12.2023,  
PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË  
POGRADEC"**



Me respekt

**Kryetari**

**Ilir XHAKOLLI**

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 faqe

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 2 faqe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI



Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Pogradec, më \_\_\_\_\_ .2024

**PROJEKTVENDIM**

**NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_\_ .2024**

**PËR**

**" DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 133, DATË 11.12.2023,  
PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË  
POGRADEC"**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja "b", nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja "f", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr.44/2015, "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr.115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit, të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve e rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Të miratojë disa shtesa në pikën II.16 “ Tarifa për kuotat ushqimore në kopshte e çerdhe” të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 133, datë 11.12.2023, për “Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec”, si më poshtë:



**II.16 Tarifa për kuotat ushqimore në kopshte e çerdhe:**

<b>Tarifë për kopshtet</b>	<b>Njësi</b>	<b>Vlerë</b>
Tarifë për kopshte	Kuota mujore lekë/fëmije	3960
<b>Tarifë për çerdhet</b>	<b>Njësi</b>	<b>Vlerë</b>
Tarifë për çerdhet	Kuota mujore lekë/fëmije	3300

**II.16.1.** Efektet financiare fillojnë menjëherë me fillimin e vitit të ri mësimor 2024-2025.

**II.16.2.** Ngarkohet Qendra Arsimore për vjeljen e kësaj tarife ku pagesa kryhet pranë Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

**II.16.3.** Në rast se fëmija mungon në kopsht ose çerdhe 5 ose më shumë ditë të cilat do të jenë të justifikuara me raport, këto ditë do të zbriten nga vlera mujore që prindi ka detyrim të paguajë.

**II.16.4.** Në rastet kur fëmija mungon gjatë gjithë muajit prindi nuk ka asnjë detyrim për të paguar.

**II.16.5.** Lidhja e kontratës midis drejtorisë së kopshteve/çerdhes dhe prindit të fëmijës.

2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” ,i ndryshuar).

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**Manjola KAMOLLI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI



Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Pogradec, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

RELACION

MBI

**" DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 133, DATË 11.12.2023,  
PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË  
POGRADEC"**

Në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e Premte u zhvillua një takim me prindërit e fëmijëve të regjistruar në kopshtet dhe çerdhen me ushqim, anëtarët e Këshillit Bashkiak, N/Kryetaren e Bashkisë Pogradec, Drejtoreshën e Kabinetit, anëtarë të bordeve të kopshteve si edhe specialistë të Qendrës Arsimore.

Në këtë takim u diskutua:

- Tarifa ushqimore e kopshteve dhe çerdhes
- Problematikat e ndryshme në Institucionet Arsimore
- Përpilimi i kontratës midis Qendrës Arsimore dhe prindërve që do të regjistrojnë fëmijët në kopshtet dhe çerdhe
- Mirëmbajtja dhe pajisja e godinave me materialet e nevojshme për një proces mësimor sa më komod për fëmijët.

Në përfshirje të plotë midis të gjitha palëve, u dakordësua në pikat si më poshtë :

1. Duke nisur nga 5 ose më shumë ditë mungese të fëmijës gjatë muajit mund të justifikohet me raport mjekësor dhe këto ditë të mos përfshihen në pagesën fikse mujore
2. Qendra Arsimore të kërkojë më shumë fonde në buxhetin vjetor për mirëmbajtjen e Institucioneve Arsimore si edhe të pajisë me materialet e nevojshme këto IA (mjete didaktike, lodra, mjete mësimore, etj.)
3. ¶ Në rastet kur fëmija mungon gjatë gjithë muajit prindi nuk do të paguajë asnjë detyrim përsa i përket muajin përkatës

Falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit për prezencën, kohën dhe sugjerimet e tyre!

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, ju ftojme ta votoni propozimin për miratimin e Projekt-Vendimit mbi " Disa shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 133, datë 11.12.2023, për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec"



**Të dhënat e Projekt-Vendimit:**

Konceptoi: Ledio Shkullaku

Pranoi: Majlinda Çuni

Miratoi: Anxhela Andoni

Konfirmoi: Dritan Babasuli

**KRYETAR**

**Ilir XHAKOLLI**